

KONFERENCË
NDËRKOMBËTARE

QASJE NDËRDISIPLINORE,
SINERGJI DHE RISI
NË SHKENCAT HUMANE DHE
SHOQËRORE

20-21 TETOR 2025

BIBLIOTEKA
E UNIVERSITETI "LUIGJ GURAKUQI"

SHKODËR, SHQIPËRI



CISVA CENTRO INTERNAZIONALE
SUL VIAGGIO ADRIATICO



ART HOUSE

Universiteti « Luigj Gurakuqi », Shkodër, Shqipëri
Departamenti i Romanistikës
dhe
Fakulteti i Gjuhëve dhe Shkencave Humane
&
Instituti i Gjuhëve dhe Letërsive Evropiane
Universiteti Haute-Alsace, Francë

Thirrje për
Konferencë Ndërkombëtare

Qasja ndërdisiplinore, sinergji dhe risi në shkencat humane dhe shoqërore

20-21 tetor 2025

Qëllimi

Qëkur Edgar Morin pohoi se “qasja ndërdisiplinore imponohet qartazi, sapo ndryshojmë këndvështrimin mbi botën, duke e parë atë si një ndërlidhje sistemesh” (La Méthode, 1981), disiplinat shkencore u përballën gjithnjë e më shumë me domosdoshmërinë për të bashkëvepruar, me qëllim përballjen me sfidat e shumëllojshme të shoqërisë bashkëkohore. Globalizimi i shkëmbimeve, intensifikimi i ndërveprimeve shoqërore dhe kulturore, si dhe përdorimi i gjerë i teknologjive të reja kanë ridimensionuar praktikatat e kërkimit shkencor duke nxitur dhe favorizuar zhvillimin e qasjeve ndërdisiplinore.

Nisur nga ky kontekst, propozojmë këtë konferencë ndërkombëtare si një hapësirë reflektimi e shkëmbimi mbi ndërveprimet dhe sinergjitë ndërmjet shkencave gjuhësore, letërsisë, arteve, dhe disiplinave të tjera humane dhe shoqërore, për të evidentuar karakterin inovator të qasjeve ndërdisiplinore qofshin ato teorike, metodologjike apo të zbatuara.

Shkencat gjuhësore, përmes zhvillimit të mjeteve për të analizuar dhe përmirësuar praktikatat komunikuese dhe ligjëruese, kontribuojnë në përballjen me sfidat e një bote të globalizuar dhe multikulturore. Nga ana tjetër, studimet letrare si shprehje artistike dhe kritike e gjuhës, ndihmojnë në formësimin e identiteteve individuale dhe kolektive duke pasuruar kujtesën kulturore. Këto fusha, në një ndërveprim të përhershëm, pasurohen reciprokisht përmes ndërveprimit me disiplina të tjera si shkencat shoqërore, filozofia apo shkencat ekzakte.

Ftojme studiuesit me përvojë, studiuesit e rinj, pedagogët dhe doktorantët të paraqesin propozime sipas tematikave të mëposhtme, pa synuar të jenë shteruese, me qëllim një reflektim kolektiv mbi sfidat teorike, metodologjike dhe shoqërore të qasjes ndërdisiplinore.

I : Gjuhësi

- **Zhvillimet gjuhësore në një shoqëri globale** : sfidat e kontakteve mes gjuhëve, transformimet e përdorimeve gjuhësore dhe ruajtja e gjuhëve në rrezik.
- **Analiza e ligjërimit në kontekste të ndryshme** : politik, mediatik, turistik, rrjete sociale, dhe përfshirja social-kulturore.
- **Sfidat e komunikimit ndërkulturor** : problematikat në lidhje me përkthimin, keqkuptimet kulturore dhe negocimet identitare.

II : Letërsi dhe identitete kulturore

- **Letërsia dhe kujtesa kolektive** : roli i letërsisë në transmetimin dhe rimodelimin e identiteteve kulturore dhe historike.
- **Risitë digjitale dhe letërsia** : mënyra të reja të të bërit letërsi, të publikimit dhe marrjes së informacionit në një botë të dominuar gjithnjë e më shumë nga teknologjia në epokën digjitale.
- **Letërsia dhe trauma kolektive** : ndërveprimi mes letërsisë, kujtesës dhe qëndresës në periudha vështirësish dhe fatkeqësish përgjatë historisë njerëzore.

III : Qasje ndërdisiplinore

- **Shkencat humane ndërmjet digjitalizimit dhe teknologjive të reja** : përdorimi i mjeteve digjitale në analizën e korpusit në shkencat humane dhe shoqërore, mundësi të reja për publikimin e rezultateve të kërkimit shkencor (platformat dhe bibliotekat digjitale, muzeumet virtuale etj).
- **Artet, trashëgimia dhe komunikimi ndërkulturor** : bashkëveprimi mes praktikave artistike, ruajtjes së trashëgimisë dhe dialogut mes kulturave.
- **Etika ndërdisiplinore** : reflektime kritike mbi sfidat etike si rrjedhojë e kërkimeve ndërdisiplinore dhe bashkëpunimi brenda sektorëve të së njëjtës fushë.
- **Inteligjenca artificiale dhe shkencat humane** : përfshirja epistemologjike, metodologjike dhe shoqërore e aplikacioneve të Inteligjencës artificiale në kërkimin shkencor.
- **Praktika inovatore në pedagogji** : zbatimi i qasjeve ndërdisiplinore në formimin e studentëve dhe impakti mbi zhvillimin e kompetencave transversale.
- **Bashkëpunimi në kërkimin shkencor dhe konteksti multikulturor** : ndërveprime të suksesshme ndërmjet disiplinave dhe kulturave në projekte konkrete kërkimore-shkencore.
- **Sfidat institucionale të ndërdisiplinaritetit** : njohja, financimi dhe vlerësimi i qasjeve ndërdisiplinore në politikat kërkimore shkencore.

Informacione të rëndësishme :

Propozimet duhet të përmbajnë: titullin e punimit, të dhënat personale (emër, mbiemër, adresë elektronike), institucionin ku është i/e punësuar, përcaktimin e fushës së kontributit të dërguar, një përmbledhje rreth 300 fjalë, 3-5 fjalë kyçe, 5 referenca bibliografike.

Punimet mund të dërgohen në gjuhën shqipe, frënge, italiane ose angleze, në adresën e mëposhtme : konfrom2025@unishk.edu.al

Ju ftojmë të shpërndani thirrjen pranë grupeve tuaja profesionale dhe akademike.

Kalendari :

Afati i fundit për dorëzimin e propozimeve : **15 shtator 2025**

Njoftimi i pranimit : **25 shtator 2025**

Publikimi i programit të konferencës : **10 tetor 2025**

Zhvillimi i konferencës : **20–21 tetor 2025**

Vendi : **Biblioteka Universitare**, Rruga Jeronim De Rada, Shkodër, Shqipëri

Gjuhët e punës : shqip, frëngjisht, anglisht, italisht

Botimi i akteve: Botimi i kontributeve është parashikuar në revistën shkencore “Buletini i Universitetit të Shkodrës”.

Komiteti shkencor:

Tonin Gjuraraj, Universiteti i Shkodrës «Luigj Gurakuqi», Shqipëri
Greta Komur-Thilloy, Universiteti Haute-Alsace, Francë
Régine Battiston, ILLE, Universiteti Haute-Alsace, Francë
Laurent Curelly, Universiteti Haute-Alsace, Francë
Dhurata Hoxha, Universiteti i Shkodrës «Luigj Gurakuqi», Shqipëri
Eliana Laçeaj, Universiteti i Shkodrës «Luigj Gurakuqi», Shqipëri
Amélie Lombardini, Ambasada e Francës, Shqipëri
Etleva Nallbani, CNRS, France
Artan Haxhi, Universiteti i Shkodrës «Luigj Gurakuqi», Shqipëri
Esmeralda Kromidha, Universiteti i Tiranës, Shqipëri
Eldina Nasufi, Universiteti i Tiranës, Shqipëri
Silvana Vithshkurti, Universiteti Politeknik i Tiranës, Shqipëri
Valbona Berisha, Universiteti i Prishtinës «Hasan Prishtina», Kosovë
Nertila Larja, Universiteti i Shkodrës «Luigj Gurakuqi», Shqipëri
Tatiana Musinova, Universiteti Haute-Alsace, Francë
Felipe Aparicio, Universiteti Haute-Alsace, Francë
Emmanuel Nal, LISEC, Universiteti Haute-Alsace, Francë
Fabrice Marsac, Universiteti i Strasburgut, Francë
Marzena Watorek, Universiteti Paris 8, Francë
Elzbieta Biardzka, Universiteti i Wroclaw-it, Poloni
Lorenzo Devilla, Universiteti i Sassari-t, Itali
Marine Totozani, Universiteti «Jean Monnet», Francë
Elona Tora, AUF Shqipëri
Alma Hafizi, Universiteti i Shkodrës «Luigj Gurakuqi», Shqipëri
Drita Brahimi, Universiteti i Shkodrës «Luigj Gurakuqi», Shqipëri
Edlira Bushati, Universiteti i Shkodrës «Luigj Gurakuqi», Shqipëri
Adrian Paci, Art House Shkodër, Shqipëri
Giovanna Scianatico, CISVA, Itali
Patrizia Guida, CISVA, Itali
Alva Dani, Universiteti i Shkodrës «Luigj Gurakuqi», Shqipëri
Angelina Shllaku, Universiteti i Shkodrës «Luigj Gurakuqi», Shqipëri
Pierre Thilloy, Universiteti Haute-Alsace, Francë
Sladjana Djordjevic, Universiteti Haute-Alsace, Francë
Lindita Kazazi, Universiteti i Shkodrës «Luigj Gurakuqi», Shqipëri
Aterda Lika, Universiteti i Shkodrës «Luigj Gurakuqi», Shqipëri
Karmen Kazri, Universiteti i Shkodrës «Luigj Gurakuqi», Shqipëri

Komiteti Organizativ

Dhurata Hoxha
Lindita Kazazi
Aterda Lika
Alva Dani
Ingrit Tirana